

## RREGULLAT DHE KUSHTET E ANKANDIT

Ambasada e Sh.B.A. në Tiranë shet artikujt e tepërt nëpërmjet ankandit "online" në internet.

Artikujt e tepërt do të shiten duke u bazuar në rregullat e përcaktuara nga Departamenti i Shtetit i Sh.B.A.. Secili grup artikujsh do të ketë një numër të veçantë (numri i grupit), një përshkrim të detajuar, gjendjen aktuale, funksionalitetin si dhe një sërë fotosh.

Ambasada e Sh.B.A në Tiranë nuk jep asnjë garanci për artikujt që bliu. Ato do të shiten në gjendjen ekzistuese. Artikujt nuk mund të kthehen apo të rimbursohen.

Artikujt e tepërt do të shiten nëpërmjet aplikacionit "online" të ankandit në internet në faqen:

U.S. Embassy Online Auction (<https://online-auction.state.gov/en-US>).

Ju duhet të jeni mbi 18 vjeç për të marrë pjesë në ankandin "online". Secili pjesëmarrës duhet të krijojë një llogari tek "U.S. Embassy Online Auction (<https://online-auction.state.gov/en-US>)". Çdo llogari duhet të përmbajë adresë "email-i" të vlefshme si dhe një numër telefoni të vlefshëm. Për më tepër informacion në lidhje me mbrojtjen e të dhënave tuaja personale, shihni politiken tonë të privatësisë në faqen: "U.S. Embassy Online Auction (<https://online-auction.state.gov/en-US>)".

### **KËRKESA TE VEÇANTA PËR PUNONJËSIT ME NËNSHTETËSI AMERIKANE:**

Punonjësit me nënshtetësi amerikane dhe të afërmit e tyre mund të marrin pjesë në shitjet konkurruese dhe të shpallura publikisht të artikujve të aturizuar për t'u shitur, me kusht që punonjësi të vërtetojë me shkrim: (1) Që artikujt janë për përdorimin personal të punonjësve; (2) Që punonjësi nuk do t'i shesë artikujt gjatë periudhës së qëndrimit të tij në post përveç se një punonjësi tjetër të Qeverisë Amerikane i cili, nga ana e tij, do të japë të njëjtin vërtetim me shkrim; (3) Që, nëqoftë se në fund të periudhës së qëndrimit në post, punonjësi ia shet këto artikuj një personi tjetër që nuk gëzon privilegjin e të qenit i çliruar nga taksat, punonjësi do të vërtetojë me shkrim para zyrtarit përgjegjës për shitjen e artikujve, që çdo taksë lokale apo detyrime të tjera janë përmbushur.

**ANKANDI:** Çdo ankand do të aktivizohet për një periudhë kohore me afate të përcaktuara qartë. Ky informacion është i disponueshëm në panelin e informacionit të aplikacionit në internet. Zakonisht do të jetë aktiv nga e hëna në të premte për një periudhë dy javore. Përgjatë kësaj periudhe ju mund të merrni pjesë aktive dhe të ofroni ofertat tuaja për artikujt e tepërt.

Numri maksimal i ofertave për një artikull përcaktohet në çdo artikull për shitje. Dhënia e ofertave më të larta është e mundur vetëm në Lekë shqiptare. Gjatë ankandit duhet të monitoroni ofertat tuaja në mënyrë që të keni mundësinë për t'i përshtatur ato në bazë të rritjes së cmimit në ofertë. Pas mbylljes së ankandit, sistemi do të vlerësojë ofertat më të larta në mënyrë automatike dhe do t'i dërgojë fituesit një njoftim për t'i bërë të ditur këtë informacion. Në rast se ju keni dhënë ofertën më të lartë dhe nuk keni marrë njoftimin ku ju bëhet i ditur ky fakt, ju lutem na kontaktoni në adresën e email-it: [TiranaAuction@state.gov](mailto:TiranaAuction@state.gov). Në disa raste ju do të kontaktoheni nga administratorët e ankandit.

**SI BËHET PAGESA DHE TËRHIQEN ARTIKUJT:** Është e nevojshme që pagesa dhe tërheqja e artikujve të kryhet brenda afatit të përcaktuar. Ky afat dhe çdo informacion tjetër mund të gjendet në faqen e ankandit në internet: U.S. Embassy Online Auction (<https://online-auction.state.gov/en-US>) në seksionin "Informacion për Fituesin".

Pagesa për artikujt tuaj është e mundur vetëm me transfertë bankare të parave në llogarinë bankare të Ambasdës:

### **INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA**

Emri i llogarisë: USA Embassy sweep account  
Numri i llogarisë: 2007531804  
Kodi IBAN: AL12208110080000002007531804  
Monedha: ALL (LEK)  
Kodi SWIFT: USALALTR

1. Në pikën "Detajet e Transaksionit" vendosni fjalën "Ankand", Numrin tuaj Unik të Identifikimit (NUI) (per shembull, **TIA0001-000853**) i cili mund të gjendet në seksionin "Informacion për Fituesit" të ankandit në internet si dhe numrat e grupeve (p.sh. **Grupi 1; 4; 10**) që ju jeni duke paguar.
2. Në pikën "Shuma" vendosni shumën totale në monedhën vendase të ofertës apo ofertave tuaja.

Në rast se ju keni dhënë oferta dhe keni fituar më shumë se një artikull/Grup ju mund të paguani shumën që detyroheni për të gjithë artikujt në vetem një pagesë, por të gjitha grupet duhet të identifikohen qartë siç përshkruhet në pikën 1 më sipër. Artikujt mund të tërhiqen vetëm pasi pagesa të jetë e suksesshme dhe të jetë pranuar. Marrja e pagesës konsiderohet e plotë vetëm kur paratë arrijnë në llogarinë bankare të Ambasadës së SH.B.A..

Shënim: Mund të duhet më shumë se një ditë për të transferuar paratë nga banka juaj në bankën e Ambasadës së SHBA. Ju nuk mund të tërhiqni artikujt tuaj në qoftë se pagesa juaj nuk konfirmohet në llogarinë bankare të Ambasadës së SH.B.A..

**TERHEQJA E ARTIKUJVE:** Për të bërë të mundur tërheqjen e artikujve, ju duhet të paraqisni faturën origjinale të transfertës bankare ku përfshihen të gjitha detajet e kërkuara në paragrafin e mësipërm apo një version të printuar të transfertës bankare në internet.

Çdo artikull që nuk tërhiqet gjatë afatit kohor të përcaktuar do të përjashtohet nga ankandi dhe nuk do të ketë më mundësi që të tërhiqet. Në raste apo rrethana të vecanta, ju mund të caktoni një datë dhe kohë tjetër jashtë afatit kohor duke kontaktuar me administratorët e ankandit në adresën e email-it [TiranaAuction@state.gov](mailto:TiranaAuction@state.gov).

Pas konfirmimit që pagesa për artikujt tuaj është bërë me sukses, punonjësit tanë do të nxjerrin artikujt tuaj në hyrje të magazinës. Nga ky moment ju jeni pronar i mallit. Ju keni përgjegjësinë e plotë për të gjitha procedurat e mëvonshme si dhe tërheqjen e mallit brenda një kohe të arsyeshme. Në qoftë se artikujt nuk lëvizin brenda kësaj kohe ato mund të konsiderohen të braktisura dhe të asgjësohen.

**IDENTIFIKIMI:** Çdo fitues në ankand duhet të paraqesë një dokument identifikimi.

**TAKSAT APO DETYRIMET:** Blerësi është vetë përgjegjës për pagesën e çdo detyrimi doganor apo detyrimi tjetër ndaj shtetit shqiptar.

**SHËNIM: ÇMIMET E OFRUARA DUHET TE JENË NË LEKË "TË REJA".**